

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Raporte Financiare 3-Mujore

Sipas Kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 [i ndryshuar] te Bankes se Shqiperise

Për periudhën e mbyllur më: 30/9/2016

PERMBAJTJA:	Faqe
1. Bazat e pergatitjes dhe Permbledhje e Politikave Kontabel	1 - 6
2. Tregues te rentabilitetit te bankes	7
3. Pozicioni financiar, Pasqyra e te Ardhurave dhe zerat jashte bilanci te permbledhura	8 - 11
4. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	12
5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë	13
6. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike (rretheve)	14 - 15
7. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas tipit te industrise dhene rezidenteve (rretheve)	16 - 17
8. Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes	18
9. Aktivitet sipas maturimit përfundimtar	19
10. Pasivet sipas maturimit përfundimtar	20
11. Struktura e kapitalit rregullator; Raporti i mjaftueshmërise së kapitalit: Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional	21

Tiranë, më 24/10/2016

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a (“Banka”) është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme.

Bazuar në nenin nr.2 të Statutit të Bankës, objektivi i Bankës është të veproje, për llogari të vet apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Raiffeisen Bank sh.a. është krijuar dhe themeluar si dhe operon vetëm në Shqipëri. Raiffeisen Bank sh.a. është shoqëri e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri me 100 % të kapitalit.

Më 30 Shtator 2016, Banka operon me një rrjet bankar prej 85 pika shërbimi në të gjithë Shqipërinë (31 Dhjetor 2015: 89 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 6 Distrikte. Numri i punonjësve të Bankës më 30 Shtator 2016 ishte 1,384 punonjës (31 Dhjetor 2015: 1,406 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregulatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptarë (“Lek”), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lek, cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

(ii) Transaksionet dhe gjendjet

Transaksionet e kryera në monedha të tjera (jo Lek) janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 30 Shtator 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 (Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	30 Shtator 2016	31 Dhjetor 2015
Monedha Europiane (EUR)	137.33	137.28
Dollari Amerikan (USD)	122.74	125.79
Paundi Britanik (GBP)	159.14	186.59
Franga Zvicerane (CHF)	126.59	126.74
Jeni Japonez (JPY) (për 100)	121.42	104.50
Dollari Kanadez (CAD)	93.32	90.53

3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë (“Banka Qëndrore”).

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.3 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për rënien në vlerë.

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e tregut

Vlera e tregut për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara përcaktohet duke i referuar çmimeve të ofruara (bid) të kuotuar gjatë mbylljes së bursës në datën e bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së tregut përcaktohet duke i referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër, i cili është i përafërt në natyrë. Vlera e tregut, gjithashtu, mund të bazohet në rrjedhjen e pritshme të parasë, ose mbi bazën neto të aktivitetit për letrën me vlerë në fjalë.

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje të anasjellta të riblerjes) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlloritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha këto marrëveshje bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.4 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Banka i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Banka dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjionet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjioneve të përgjithshme të njohura në bilancin e Bankës, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer të detyrimit.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Deget e Bankave të Huaja” miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjioneve:

Kategoria e huasë	Provigjoni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjionin për huatë e këqija, shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën individuale të të ardhurave në zërin “Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative”.

Banka nuk përllorarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbetur e huave, për të cilat nuk përlloraritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjionin për humbjet e pritshme. Provigjioni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

Politikat e fshirjes së kredive

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

3.5 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara shprehen me koston historike të blerjes plus rivlerësimet (në rastin e ndërtesave) minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Ndërtesat shprehen me vlerat e rivlerësuara, të cilat janë vlerat reale në bazë të përdorimit aktual në datën e rivlerësimit, minus ndonjë zhvlerësim pasues të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë vijuese të akumuluar. Rezultati i rivlerësimit është paraqitur në rezervat e rivlerësimit.

Zhvlerësimi dhe amortizimi paraqiten si pakësim i koston së mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim dhe duke aplikuar përqindjet e zhvlerësimit si më poshtë:

Kategoria	Përqindjet vjetore të amortizimit (%)
Ndërtesa	5
Pajisje kompjuterike	25
ATM	25
Mjete transporti	20
Mobilje dhe pajisje	20
Aktive të patrupëzuara	12.5

Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën individuale të të ardhurave në periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.6 Pronat e rimarra në zotërim

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, të njohura në pasqyrat financiare individuale si “Aktive të tjera”. Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

3.7 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.8 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

3.9 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përlllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

3.10 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitim të pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet 15% (31 dhjetor 2015: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.12 Pjesëmarrje në filial

Banka zotëron 75% të aksioneve të Raiffeisen Leasing Sh.a. ndërsa pjesa tjetër e 25% të kapitalit është në pronësi të Raiffeisen Leasing International G.m.b.H. Raiffeisen Leasing Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar sipas vendimit të Gjykatës së Tiranës Nr.35733 të datës 15 Maj 2006 dhe ushtron aktivitetin e qiradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm “Mbi Qiradhënien Financiare”.

Banka ka blerë 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Sh.a. Blerja është aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr 30, datë 26 mars 2009, regjistruar në Qendra Kombëtare e Regjistrimit më 23 prill 2009.

Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rezultatin dhe aktivet neto të Raiffeisen Leasing Sh.a., dhe Raiffeisen INVEST Sh.a. Investimi në këto filiale është raportuar sipas metodës direkte të kapitalit, me kosto.

3.13 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qenë se për instrumentat financiarë të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiare të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Bankës kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose rikëtohen brenda vitit.

3.14 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

3.15 Krahasueshmëria

Politikat kontabël të adoptuara nga Banka janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

Tregues te rentabilitetit te bankes *

Tregues te rentabilitetit te bankes *	30/9/2016	30/6/2016	31/3/2016	31/12/2015	30/9/2015	30/6/2015	31/3/2015	31/12/2014
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100];	-	-	-	1.4 %	1.2 %	1.5 %	2.5 %	1.2 %
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.0 %	0.2 %	0.2 %	0.2 %	0.2 %	0.3 %
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	27.7 %	26.1 %	24.8 %	23.5 %	22.5 %	21.5 %	22.8 %	19.5 %
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	171 %	181 %	200 %	200 %	216 %	230 %	222 %	237 %
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100];	-	-	-	18.0 %	16.2 %	19.7 %	31.5 %	15.6 %
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000;	188,667	193,573	199,551	218,602	219,131	212,803	208,766	206,310
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	3.4 %	3.7 %	3.6 %	4.0 %	4.0 %	4.2 %	4.0 %	4.6 %
8. Marzhi neto nga interesat: [Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare qe siellin te ardhura]	4.4 %	4.6 %	4.7 %	4.9 %	4.8 %	5.0 %	4.8 %	5.3 %
9. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare;	4.1 %	4.5 %	4.1 %	4.5 %	4.6 %	4.8 %	4.6 %	5.5 %
10. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;	0.7 %	0.7 %	0.5 %	0.5 %	0.5 %	0.6 %	0.6 %	0.9 %
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	47.2 %	47.2 %	49.6 %	46.9 %	48.5 %	49.4 %	50.6 %	46.3 %
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	0.9 %	0.9 %	0.8 %	0.8 %	0.8 %	0.8 %	0.8 %	1.1 %
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	96.2 %	109.4 %	121.6 %	76.7 %	75.4 %	72.6 %	57.4 %	74.8 %
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	12.1 %	11.1 %	11.1 %	10.2 %	9.9 %	9.4 %	10.5 %	8.8 %
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	1.9 %	2.4%	2.7%	0.0%	0.0%	0.2 %	0.0%	1.0 %

(*) Treguesit jane llogaritur sipas kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise (i ndryshuar)

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci

në mijë Lekë

AKTIVET	30/9/2016	31/12/2015	Ndryshimi	ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	34,492,564	59,767,725	(25,275,161)	(42.3)%
Arka	3,135,058	3,172,435	(37,376)	(1.2)%
Banka Qëndrore	31,357,506	56,595,290	(25,237,785)	(44.6)%
Bono thesari për refinancim me Bankën Qëndrore	19,781,758	17,688,624	2,093,134	11.8 %
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	49,014,741	50,865,938	(1,851,198)	(3.6)%
Llogari rrjedhëse	551,403	1,784,395	(1,232,993)	(69.1)%
Depozita	44,785,058	43,273,216	1,511,843	3.5 %
Hua	3,445,906	3,951,869	(505,962)	(12.8)%
Të tjera	232,373	1,856,459	(1,624,085)	(87.5)%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	83,425,570	92,261,713	(8,836,143)	(9.6)%
Hua dhe paradhënie standarde	72,677,315	81,593,189	(8,915,874)	(10.9)%
Hua të pakthyera në afat	164,590	75,018	89,572	119.4 %
Hua në ndjekje	4,875,238	7,120,404	(2,245,166)	(31.5)%
Hua nënstandard	5,020,527	3,649,488	1,371,039	37.6 %
Hua të dyshimta	3,453,539	1,146,398	2,307,142	201.3 %
Hua të humbura	19,984,098	17,165,267	2,818,831	16.4 %
minus fonde rezerve per huate	(22,749,737)	(18,488,050)	(4,261,687)	23.1 %
Letra me vlerë	66,805,889	58,561,814	8,244,075	14.1 %
Letra me vlerë me të ardhura të pandryshuara	66,805,889	58,561,814	8,244,075	14.1 %
Interesa pjesëmarrëse dhe filialet	201,898	201,898	0	0%
Filialet	201,898	201,898	0	0%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	0	0	0	-
Mjetet e qëndrueshme, neto	4,504,529	4,763,436	(258,907)	(5.4)%
Mjete të trupëzuara	1,489,841	1,584,104	(94,263)	(6.0)%
Mjete të qëndrueshme në funksion të veprimtarisë	2,956,072	3,083,992	(127,920)	(4.1)%
Mjetet e trupëzuara të mbajtura për investim	44,228	89,736	(45,508)	(50.7)%
Mjete të qëndrueshme në proces	14,387	5,603	8,784	156.8 %
Mjete të tjera, neto	2,887,699	2,476,505	411,193	16.6 %
TOTALI I AKTIVEVE	261,114,647	286,587,653	(25,473,006)	(8.9)%

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci (vijon)

në mijë Lekë

DETYRIMET	30/09/2016	31/12/2015	Ndryshimi	ne %
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	5,484,348	5,176,583	307,765	5.9 %
<i>Llogari rrjedhëse</i>	1,753,546	1,911,588	(158,042)	(8.3)%
<i>Depozita</i>	3,730,802	3,264,996	465,807	14.3 %
Detyrimet ndaj klientëve	218,661,094	242,638,843	(23,977,749)	(9.9)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	135,369,098	118,825,043	16,544,055	13.9 %
<i>Llogari depozite</i>	78,676,754	119,171,919	(40,495,165)	(34.0)%
<i>Të tjera</i>	4,615,242	4,641,881	(26,639)	(0.6)%
Borxhi ndaj Qeverisë shqiptare dhe organizatave publike	352,793	342,133	10,660	3.1 %
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	1,140,072	1,055,579	84,493	8.0 %
<i>Administrimi fiskal</i>	300,552	248,335	52,218	21.0 %
<i>Të tjera</i>	839,520	807,244	32,275	4.0 %
Fond rezervë për huatë standarde dhe në ndjekje	1,057,074	1,478,627	(421,553)	(28.5)%
Fond rezervë për angazhimet dhe për rreziqe të tjera	54,466	790,238	(735,772)	(93.1)%
Detyrime të tjera	1,949,526	1,473,891	475,635	32.3 %
Borxh I varur	8,985,111	9,107,088	(121,977)	(1.3)%
TOTALI I DETYRIMEVE	237,684,484	262,062,983	(24,378,499)	(9.3)%
KAPITALI AKSIONAR				
Kapitali aksionar	14,178,593	14,178,593	0	0%
Rezerva e përgjithshme	3,270,838	3,100,000	170,838	5.5 %
Rezerva rivlerësimi	1,603,433	1,665,551	(62,118)	(3.7)%
Diferenca rivlerësimi	(390,960)	(208,943)	(182,017)	87.1 %
Fitimet e pashpërndara	5,669,467	1,973,668	3,695,799	187.3 %
Fitimi /(Humbja) e vitit ushtrimor	(901,208)	3,815,801	(4,717,009)	-
TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR	23,430,163	24,524,670	(1,094,507)	(4.5)%
TOTALI I DETYRIMEVE & KAPITALIT AKSIONAR	261,114,647	286,587,653	(25,473,006)	(8.9)%

në mijë Lekë

ZËRAT JASHTË BILANCIT	30/09/2016	31/12/2015	Ndryshimi	ne %
Angazhime të dhëna	26,767,840	23,531,917	3,235,923	13.8 %
Angazhime të marra	(54,495)	(54,623)	127	(0.2)%
Veprimet valutore (të blera - të shitura)	2,196	(44,715)	46,911	-
Angazhime të tjera	0	0	0	-

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

në mijë Lekë	01/01 deri 30/9/2016	01/01 deri 30/9/2015	Ndryshimi	ne %
Interesat				
Të ardhura nga interesat	8,485,754	9,508,651	(1,022,897)	(10.8)%
nga veprimet me banka	94,643	135,734	(41,092)	(30.3)%
nga veprimet me klientet	4,040,372	5,022,792	(982,420)	(19.6)%
nga veprimet me letra me vlerë të tjera	4,345,974	4,325,781	20,193	0.5 %
	4,766	24,343	(19,577)	(80.4)%
Shpenzime për interesa	(1,470,284)	(1,139,486)	(330,798)	29.0 %
per veprimet me banka	(103,729)	(49,022)	(54,707)	111.6 %
per veprimet me klientet	(140,858)	(561,928)	421,070	(74.9)%
per borxhet e varura	(394,983)	(359,394)	(35,589)	9.9 %
per veprimet me letra me vlerë	(830,715)	(169,142)	(661,572)	391.1 %
Te Ardhurat Neto nga Interesat	7,015,470	8,369,165	(1,353,695)	(16.2)%
Te ardhurat nga komisionet	1,915,916	1,681,325	234,590	14.0 %
nga veprimtaria huadhenese	519,593	515,996	3,597	0.7 %
nga sherbimet bankare	1,396,322	1,165,329	230,993	19.8 %
Shpenzime per komisionet	(415,775)	(300,358)	(115,417)	38.4 %
per veprimtarine huamarrese	(184,113)	(93,650)	(90,463)	96.6 %
per sherbimet bankare	(231,663)	(206,708)	(24,954)	12.1 %
Fitimi Neto nga Komisionet	1,500,140	1,380,967	119,173	8.6 %
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	436,363	360,347	76,016	21.1 %
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	4,824	4,516	308	6.8 %
Fitimi/Humbja neto nga veprimtaritë e tjera bankare	(132,248)	(43,496)	(88,751)	204.0 %
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(4,114,085)	(3,880,623)	(233,462)	6.0 %
Shpenzime për personelin	(1,794,691)	(1,716,830)	(77,860)	4.5 %
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(54,243)	(34,597)	(19,646)	56.8 %
Shpenzime për shërbime të jashtme	(2,265,151)	(2,129,195)	(135,956)	6.4 %
Amortizimi mjeteve të qëndrueshme	(544,437)	(540,195)	(4,242)	0.8 %
Humbjet nga llogaritë per t'u arketuar dhe shpenzimet për fondin rezervë per llogarite e dyshimta	(5,324,596)	(2,864,536)	(2,460,060)	85.9%
Shpenzime neto për fondet rezervë statistikore per huatë standarte & ne ndjekje	421,553	(65,877)	487,430	(739.9)%
Shpenzime neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	(4,261,687)	202,306	(4,463,993)	(2,206.6)%
Shpenzime neto për fonde të tjera rezervë	(23,633)	(75,337)	51,704	-68.6%
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(1,460,830)	(2,925,628)	1,464,798	(50.1)%
Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme	257,360	319,727	(62,366)	(19.5)%
Të ardhura jo te zakonshme	350,575	333,049	17,526	5.3 %
Shpenzime jo të zakonshme	(93,215)	(13,323)	(79,893)	599.7 %
Fitimi (Humbja) para tatimit	(901,208)	3,105,871	(4,007,079)	(129.0)%
Tatimi mbi fitimin	-	(506,640)	506,640	(100.0)%
Fitimi / (Humbja) neto per periudhen	(901,208)	2,599,231	(3,500,439)	(134.7)%

0

Të ardhurat dhe shpenzimet sipas tremujorëve

në mijë Lekë	Tr3-2015	Tr4-2015	Tr1-2016	Tr2-2016	Tr3-2016
Interesat					
Të ardhura nga interesat	2,954,102	3,028,719	2,903,561	3,128,085	2,454,109
nga veprimet me banka	43,317	44,027	37,369	34,388	22,886
nga veprimet me klientet	1,639,437	1,503,727	1,369,732	1,350,471	1,320,170
nga veprimet me letra me vlere të tjera	1,261,959	1,478,230	1,494,962	1,741,932	1,109,080
	9,389	2,736	1,498	1,295	1,973
Shpenzime për interesa	(374,418)	(284,648)	(342,814)	(654,318)	(473,153)
per veprimet me banka	(19,961)	(21,953)	(26,937)	(34,136)	(42,656)
per veprimet me klientet	(139,490)	(75,660)	(58,067)	(50,922)	(31,869)
per borxhet e varura	(151,624)	(125,233)	(123,713)	(123,686)	(147,584)
per veprimet me letra me vlere	(63,343)	(61,801)	(134,096)	(445,574)	(251,044)
Te Ardhurat Neto nga Interesat	2,579,684	2,744,072	2,560,747	2,473,767	1,980,956
Te ardhurat nga komisionet	625,942	630,810	560,943	595,884	759,089
nga veprimtaria huadhenese	168,086	223,261	158,636	146,105	214,852
nga sherbimet bankare	457,857	407,549	402,307	449,779	544,236
Shpenzime per komisionet	(101,550)	(148,551)	(119,310)	(127,052)	(169,413)
per veprimtarine huamarrese	(30,708)	(49,523)	(55,869)	(60,767)	(67,477)
per sherbimet bankare	(70,842)	(99,028)	(63,441)	(66,285)	(101,936)
Fitimi/Humbja nga komisionet, neto	524,392	482,259	441,633	468,832	589,676
Fitimi/Humbja neto nga veprimtaria valutore	86,632	136,001	124,038	180,883	131,442
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	1,349	2,729	1,696	1,666	1,461
Fitimi/Humbja neto nga veprimtaritë e tjera bankare	(53,041)	(65,125)	(33,148)	23,282	(122,381)
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(1,364,117)	(1,687,443)	(1,279,361)	(1,506,288)	(1,328,437)
Shpenzime për personelin	(611,721)	(696,887)	(573,073)	(617,318)	(604,299)
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(977)	(19,711)	(691)	(48,349)	(5,204)
Shpenzime për shërbime të jashtme	(751,420)	(970,844)	(705,596)	(840,621)	(718,934)
Amortizimi mjeteve të qëndrueshme	(177,445)	(178,450)	(181,993)	(179,531)	(182,913)
Humbjet nga llogarite per t'u arketuar dhe shpenzimet për fondin rezervë per llogarite e dyshimta	(1,013,322)	(729,053)	(3,114,182)	(2,092,338)	(118,076)
Shpenzime neto për fondet rezervë statistikore per huate standarte & ndjekje	161,062	(96,240)	185,466	99,188	136,900
Shpenzime neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	298,125	2,213,578	(2,077,480)	(1,464,997)	(719,209)
Shpenzime neto për fonde të tjera rezervë	(47,105)	(893,878)	(1,128,900)	99,973	1,005,294
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(1,425,404)	(1,952,513)	(93,268)	(826,501)	(541,061)
Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme	77,141	291,968	24,271	83,494	149,595
Të ardhura jo te zakonshme	78,663	294,911	96,258	98,151	156,167
Shpenzime jo te zakonshme	(1,522)	(2,943)	(71,987)	(14,657)	(6,572)
Fitimi (Humbja) para tatimit	661,273	996,958	(1,456,298)	(546,232)	1,101,322
Tatimi mbi fitimin	(170,397)	219,612	-	-	-
Fitimi (Humbja) neto per periudhen	490,876	1,216,570	(1,456,298)	(546,232)	1,101,322

0

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Gjendja më: 01/01/2016	14,178,593	1,682,141	1,417,859	1,665,551	(208,943)	1,973,669	3,815,801	24,524,671
Kalimi ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	3,815,801	(3,815,801)	0
Kalim ne rezerve ligjore	0	170,838	0	0	0	(170,838)	0	0
Diference Rivleresimi Kapitali	0	0	0	0	(182,017)	0	0	(182,017)
Rezerve rivleresimi per ndertesat	0	0	0	(62,118)	0	50,836	0	(11,283)
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	0	0	0
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	(901,208)	(901,208)
Gjendja më: 30/9/2016	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,603,433	(390,960)	5,669,467	(901,208)	23,430,163

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
